

 SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia	FORMULAR	
 SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Ospedaliera di Reggio Emilia Arcispedale S. Maria Nuova		VERSIONE IN ALBANESE QERSHOR 2013

1 – ÇFARË ËSHTË KOLONSKOPIA?

Kolonskopia është një analizë që jep mundësi të shihet direkt sipërfaqja e brendshme e kolon-it (zorrës së trashë) duke futur, nëpërmjet anusit, një instrument fleksibël me dimensione të reduktuara. Analiza ka zakonisht një kohëzgjatje të ndryshueshme nga 30 deri në 60 minuta.

Pse duhet bërë kolonskopia

Kolonskopia redukton rrezikun që të sëmuremi nga tumori i kolon-it (zorrës së trashë). Faktikisht, kolonskopia lejon diagnostikimin e parakohshëm të tumoreve që janë të pranishëm ose të polipseve që mund të bëhen tumore me kalimin e kohës. Kjo është e mundur sepse gjatë ekzaminimit mund të kryhen marrje të indeve (biopsi) ose të hiqen polipset (polipektomia).

Një kufizim i kolonskopisë është se mund të ndodhë që disa polipse të mos shihen, sidomos ato që janë më të vegjël.

2 - A ËSHTË E RREZIKSHME KOLONSKOPIA?

Komplikimet ndodhin rrallë herë dhe mund të sjellin si rezultat shtrimin në spital (rreth një rast në 200), përsëritjen e një kolonskopie ose, më rrallë, një ndërhyrje kirurgjikale.

Komplikimet më të mëdha mund të jenë:

- hemorragji në vendin e biopsisë apo të polipektomisë që mund të vërtetohet në 1 rast për 100 analiza;
- shpimi i zorrëve që mund të vërtetohet në më pak se një rast për 1.000 analiza;
- probleme kardiake ose respiratore për shkak të ilaçeve të injektuara, të cilat verifikohen shumë rrallë.

Vetëm përjashtimisht komplikimet janë të rrezikshme për jetën.

Në Qendrat e Endoskopisë së provincës Reggio Emilia profesionistët e kujdesit shëndetësor, strukturat dhe pajisjet e përdorura janë në gjendje që të ulin në minimum rrezikun e komplikimeve dhe, në rast se është e nevojshme, sigurojnë trajtimin e tyre të menjëhershëm dhe në kohë të përshtatshme.

Edhe në shtëpi, pas disa ditësh nga analizat, është e rëndësishme që të njohim paraprakisht komplikimet: në rast të humbjes së gjakut, dhimbje të barkut ose ethe duhet të kontaktojmë Qendrën e Endoskopisë (Centro di Endoscopia) ose të shkojmë te Ndihma e Shpejtë në spital (Pronto Soccorso).

Çfarë ndodh në qoftë se nuk e bëj kolonskopinë?

Mos kryerja e kolonskopisë mund të rezultojë në diagnozën e vonuar të një tumori ose mungesën e heqjes së polipeve, të cilët mund të bëhen tumore me kalimin e kohës.

Ekzistojnë analiza radiologjike alternative të kolonskopisë (p.sh. kolon TAC) të cilat, megjithatë, nuk lejojnë marrjen e mundshme të indeve ose heqjen e polipseve. Për këtë arsye, preferohet në përgjithësi kolonskopia.

3 - A SHKAKTON DHIMBJE KOLONSKOPIA?

Në përgjithësi nuk ka dhimbje, sepse zakonisht injektohen ilaçe kundër dhimbjes dhe/ose qetësues.

4 - PËRGATITJA PËR KOLONSKOPI

Që të arrihet me sukses analiza, është e domosdoshme të bëhet përgatitja e duhur e zorrëve. Prandaj duhet të ndiqen me përpikëri udhëzimet që do t'ju dorëzohen dhe duhet të merrni me kujdes produktin për pastrimin e zorrëve.

Për ata që marrin ilaçe ose janë të prekur nga ndonjë sëmundje:

Përpara analizës është e rëndësishme që të informojmë mjekun endoskopist në lidhje me ilaçet e marra, ose ndonjë alergji apo sëmundje kronike.

Për ata që marrin ilaçe për koagulimin:

Ata që marrin ilaçe kundër koagulimit (Sintrom, Coumadin) duhet të informojnë Qendrën e Endoskopisë, të paktën 10 ditë para analizës, për të marrë udhëzime në mënyrë që të arrijnë në ditën e kolonskopisë në kushte të përshtatshme për të kryer analizën në siguri. Në qoftë se nuk plotësohen kushte të tilla, analiza nuk mund të kryhet, sepse këto ilaçe shtojnë rrezikun e hemorragjisë si rrjedhim i kolonskopisë.

Kush merr vetëm një ilaç antiagregant (si aspirinetë, askriptin, kardirene, tiklid, plavix ...), mund të vazhdojë ta bëjë.

Kush merr më shumë se një ilaç antiagregant duhet të konsultohet me mjekun e tij kurues ose me kardiologun, për të vlerësuar mundësinë për të mbajtur përkohësisht vetëm acidin acetil-salicilik.

 SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia	FORMULAR	
	Adesione consapevole alla colonscopia Pranim i vetëdijshëm për kolonskopi	VERSIONE IN ALBANESE QERSHOR 2013

5 – ÇFARË NDODH PAS KRYERJES SË ANALIZËS?

Pas kolonskopisë qëndrojmë në observacion (vëzhgim) për rreth 30 minuta, që është koha e nevojshme për një zgjim të mjaftueshëm që lejon të ecim në mënyrë të pavarur dhe të përcillemi nga një shoqërues.

Kush i nënshtrohet kolonskopisë duhet të shoqërohet nga një njeri sepse, për shkak të ilaçeve qetësuese, gjatë 12 orëve pas përfundimit të analizës nuk duhet të zhvillojë aktivitete për të cilat kërkohet vëmendje, si të ngasë një automobil apo edhe thjesht të ecë vetëm në rrugë.

Pas kolonskopisë, mund të krijohen ngërçe, dhimbje barku e të përziera, që kanë tendencë të zhduken shpejt.

Pas dy orësh nga analiza mund të fillojmë të hamë, por me masë, duke shmangur frutat, perimet dhe nënproduktet e qumështit.

Duke filluar nga dita e nesërme mënyra e të ushqyerit mund të kthehet si më përpara.

SHËNIME

.....

.....

.....

.....

.....

CONSENSO INFORMATO MIRATIMI I INFORMUAR Io sottoscritta/o - Unë i/e nënshkruari/a _____ (Cognome e Nome) - (Mbiemri dhe Emri) Nato a / Lindur në _____ Il / Me _____ • sono stata/o informata/o in merito ai seguenti punti - kam qenë informuar në lidhje me pikat e mëposhtme: - çfarë është kolonskopia dhe për çfarë shërben; - avantazhet që arrihen si rrjedhim i analizave; - kufizimet dhe rreziqet e lidhura me këtë metodikë; - dëmet në rast se mungon bërja e analizave; • kam lexuar këtë formular informues dhe udhëzimet për përgatitjen për analiza; • më janë dhënë përgjigje të kuptueshme dhe të gjithanshme për pyetjet e mia dhe kërkesat për sqarim; • kam pasur kohë dhe mundësi për të vlerësuar me kujdes lajmërimet dhe të dhënat informuese që më janë dhënë. Për këtë arsye: ACCONSENTO a sottopormi alla COLONSCOPIA / MIRATOJ që t'i nënshtrohem KOLONSKOPISË dhe masave të mundshme të diagnostikimit dhe të terapisë, të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë analizave. Kjo mund të ketë të bëjë me trajtimin e patologjive të mundshme që ndeshen (asportim i polipseve, biopsi me ekzaminim histologjik, etj.), si dhe të emergjencave të mundshme që mund të paraqiten. SI / PO 0 NO / JO 0 _____ / _____ / _____ / _____ (Luogo e Data) - (Vendi dhe e Data) _____ (Firma del paziente) - (Firma e pacientit) Konfirmoj që kam dhënë informatat e përshkruara në këtë dokument, se kam verifikuar që ata janë kuptuar mirë dhe se i kam dhënë përgjigje kërkesave për sqarime që mua më janë bërë. _____ (Firma del medico endoscopista) - (Firma e mjekut endoskopist)
--

 SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia	FORMULAR	
	Adesione consapevole alla colonscopia Pranim i vetëdijshëm për kolonskopi	VERSIONE IN ALBANESE
 SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Ospedaliera di Reggio Emilia Arcispedale S. Maria Nuova		QERSHOR 2013